



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE  
 MBROJTJES SË KONSUMATORIT  
 MINISTRI

DT 23/11/2010  
 Znj. Struga,  
 Z. Kthupi  
 Ti shpërndahet  
 dhe drejtorive  
 rajonale.

225830

23/11/2010

**UDHËZIM**

Nr. 19 Datë 17/11 2010

**PËR**

**METODAT E MARRJES SË MOSTRAVE DHE ANALIZIMIT PËR KONTROLLIN ZYRTAR TË NIVELIT TË NITRATEVE NË PRODUKTET USHQIMORE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të ligjit nr.9863 datë 28.01.2008 "Për Ushqimin", Kreu XI neni 41 "Objekti i kontrollit zyrtar të ushqimeve", neni 76 të ligjit 9590 datë 27.07.2006 "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian dhe shteteve të tyre anëtare" dhe V.K.M. Nr. 463 datë 05.07.2006 "Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit" i ndryshuar

**UDHËZOJ:**

1. Marrja e mostrave, përgatitja e tyre dhe analizimi për kontrollin zyrtar të nivelit të nitrateve në produktet ushqimore të bëhen sipas përcaktimeve të dhëna në Shtojcën "Metoda e marrjes së mostrës, përgatitja e mostrës dhe analizat për kontrollin zyrtar të niveleve të nitrateve në disa produkte ushqimore" bashkëlidhur këtij Udhëzimi (më poshtë Shtojcë).
2. Mostrat e caktuara për kontrollin zyrtar të niveleve të nitratisë në produktet ushqimore listuara në Shtojcë të merren sipas metodave paraqitur në këtë Shtojcë. Mostra e përbërë, e marrë direkt nga fusha ose lot-et, të konsiderohet si përfaqësuese e tyre. Përputhshmëria të vendoset në bazë të niveleve të përcaktuara në mostrat laboratorike.
3. Me termat e mëposhtëm do të kuptohet:
  - a) 'lot' kuptohet një sasi e identifikueshme e një produkti ushqimor prodhuar dhe shpërndarë në të njëjtën kohë dhe të konfirmuar zyrtarisht se ka karakteristika të përbashkëta të tilla si:

originën, llojin ose tipin e tokës brenda një hapësire maksimale prej 2 ha, tipin e paketimit, paketuesin, dërguesin ose etiketuesin;

b) 'nënlot' kuptohet një pjesë e përcaktuar e një lot-i të madh ku aplikohet metoda e marrjes së mostrës mbi këtë pjesë; secili nënlot duhet të jetë fizikisht i ndarë dhe i identifikueshëm.

c) 'mostër shtesë ose njësi' kuptohet një sasi e materialit të marrë nga një vend i vetëm i lot-it ose nënlot-it. Në këtë rast ajo mund të jetë një marule e vetme ose një rrënjë spinaq, një pjesë e vogël e gjetheve të reja ose një qese me gjethe të prera.

ç) 'mostër e përbërë' kuptohet shuma e kombinuar e të gjithë mostrave shtesë të marra nga lot-i ose nënlot-i.

d) 'mostër laboratorike' kuptohet një mostër e paracaktuar për laborator.

e) 'fushë' kuptohet një sipërfaqe e caktuar toke me të njëjtin tip toke dhe praktikë kultivimi, që përmbajnë një varietet të vetëm marule ose spinaqi në të njëjtën fazë rritje. 'Fusha' mund të konsiderohet si 'lot' për metodën e marrjes së mostrës.

f) 'sipërfaqe e mbuluar' kuptohet një serë xhami ose një politunel (tunel plastik ose polietileni apo serë) që përmban një varietet të vetëm marule ose spinaqi në të njëjtën fazë rritje dhe të vjelë në të njëjtën kohë. 'Sipërfaqja e mbuluar' mund të konsiderohet si 'lot' për metodën e marrjes së mostrës.

4. Marrja e mostrës të bëhet nga një person i autorizuar i përcaktuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU).

5. Lot-et të cilat do të ekzaminohen të mostrohen më vete. Lotet e mëdha (lot-e më shumë se 30 ton ose më të mëdha se 3 ha) të ndahen në nënlot-e për tu mostruar më vete.

6. Gjatë marrjes së mostrave dhe përgatitjes së tyre, të merren masat paraprake të mëposhtme për të shmangur çdo ndryshim, i cili mund të ndikojë:

- në përmbajtjen e nitratit, duke ndikuar në mënyrë të kundërt në përcaktimin analitik ose e bën mostrën e përbërë jopërfaqësuese, p.sh. prania e dheut në marule ose spinaq gjatë përgatitjes së mostrës.
- sigurinë ushqimore ose integritetin e lot-eve të mostruar.

Gjithashtu, të merren të gjitha masat e domosdoshme që garantojnë sigurinë e personave që marrin mostrat.


7. Sa më shumë të jetë e mundur, mostrat shtesë të merren në vende të ndryshme të shpërndara gjatë gjithë lot-it ose nënlot-it. Nisja e procedurës të bëhet duke regjistruar të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën 11 të këtij Udhëzimi.

8. Mostra e përbërë të formohet nga kombinimi i mostrave shtesë.
9. Mostrat përsëritëse të përdorura për qëllime justifikimi dhe reference të merren nga mostra e përbërë e homogjenizuar, përveç rasteve kur ka mospërputhje të operatorit të biznesit me të dhënat e analizës.
10. Secila mostër të vendoset në një qese plastike të pastër, të errët, të mbyllur e të palëvizshme për të penguar humbjen e lagështirës dhe të sigurojë mbrojtje të mjaftueshme ndaj çdo dëmtimi ose kontaminimi. Mostra të transferohet në laborator brenda 24 orëve nga marja e saj dhe të mbahet e freskët gjatë transportit. Nëse kjo nuk është e mundur mostra duhet të futet në ngrirje brenda 24 orëve dhe të mbahet e ngrirë (maksimumi deri në gjashtë javë). Për të penguar çdo ndryshim në përbërjen e mostrës, që mund të ndodhë gjatë transportit ose ruajtjes të merren masa paraprake shtesë të nevojshme.
11. Çdo mostër e marrë për qëllim të kontrollit zyrtar të vuloset në vendin e marrjes së mostrës. Të regjistrohen të gjitha mostrat që merren, duke bërë që çdo lot të identifikohet qartë dhe zyrtari që merr mostrën të shënojë varietetin, rritësin, metodën e prodhimit, datën, vendin e marrjes së mostrës, operatorin e biznesit ushqimor përgjegjës për ngarkesën, dhe çdo informacion tjetër, në mënyrë të tillë që të jetë ndihmë për analizuesin.
12. Metoda e marrjes së mostrave të aplikohet në të gjitha format në të cilat produktet vendosen në treg (grumbuj ose kontenierë, që përfshijnë thasë, çanta dhe kuti ose paketa të shitjes me pakicë).
13. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij Udhëzimi.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

GENC RULI



Konc L. Çuko  
M Gjeta  
Dr DSU G. Moka  
Dr. Jur F. Piperi  
Sek Përgj A Kushti

## Shtojcë

### **Metoda e marrjes së mostrës, përgatitja e mostrës dhe analizat për kontrollin zyrtar të niveleve të nitrateve në disa produkte ushqimore.**

#### **A. METODA E MARRJES SË MOSTRAVE**

Sa më shumë të jetë e mundur, mostrat shtesë të merren në vende të ndryshme gjatë gjithë lot-it ose nënlot-it.

##### **A.1. Marrja e mostrave në fushë**

Marrja e mostrave për marulen dhe spinaqin kryhet si më poshtë:

Mostrat shtesë nuk do të mblidhen nga sipërfaqet që duken si jopërfaqësuese të fushës ose të sipërfaqes së mbuluar. Sipërfaqet me tipe të ndryshme toke, që i janë nënshtruar praktikave të ndryshme të kultivimit ose që përmbajnë varietete të ndryshme marule ose spinaq, apo që janë vjelë në kohë të ndryshme, të trajtohen si lot-e ose fusha të ndara. Nëse fusha është më e madhe se 3 ha, fusha të ndahet në nënlot-e me 2 ha secila dhe secili nënlot të mostrohet më vete.

Mostrat shtesë të mblidhen nga përshkimi i një modeli që formon një 'W' ose 'X' përmes fushës. Prodhimet e vjela nga shtretër të ngushtë ose sipërfaqe të mbuluara të vilen sipas një modeli që formon një 'W' ose 'X' dhe të grumbullohen për të formuar mostrën e përbërë.

Bimët duhet të priten në nivelin e tokës.

Mostra duhet të përmbajë të paktën 10 bimë, dhe mostra e përbërë nga 10 bimë duhet të peshojë të paktën 1 kg. Vetëm njësitë e një madhësie të tregtueshme do të merren për mostër. Toka, pjesët e pangrënshme dhe të dëmtuara largohen nga çdo njësi.

##### **A.2. Marrja e mostrës në lot-et e spinaqit, marules, ushqimeve të fëmijëve dhe ushqimeve me bazë drithëra të përpunuara për foshnja dhe fëmijë të vegjël.**

Metoda e marrjes së mostrës aplikohet në lot-e më të vegjël ose të barabartë me 25 ton.

Në rastin e lot-eve të mëdha (lot-e > 30 ton), lot-i do të ndahet në nënlot-e në parimin 25 ton me kusht që nënlot-i të ndahet fizikisht. Duke marrë parasysh peshën e lot-it jo gjithmonë është shumëfish i 25 ton, pesha e nënlot-it mund të tejkalojë peshën e përmendur maksimumi deri në 20%. Kjo nënkupton që nënlot-i mund të ketë peshë rreth 15 deri 30 ton. Në rast se lot-i nuk mund të ndahet në nënlot-e, mostra merret nga lot-i.

Mostra e përbërë do të jetë të paktën 1 kg, me përjashtim të rasteve kur nuk është e mundur, p.sh. kur mostra merret nga një rrënjë ose paketë e vetme.

Numri minimal i mostrave shtesë të marra nga lot-i jepet në Tabelën 1 të kësaj Shtojcë.

**Tabela 1:** Numri minimal i mostrave shtesë të marra nga lot-i

Pesha e lot-it (kg)	Numri minimal i mostrave shtesë të marra	Pesha minimale e mostrës së përbërë (kg)
< 50	3	1
50 deri 500	5	1
> 500	10	1

Nëse lot-i përbëhet nga paketa individuale, atëherë numri i paketave që do të merren për të formuar mostrën e përbërë jepet në Tabelën 2 të kësaj Shtojce.

**Tabela 2:** Numri i paketave (mostrave shtesë) që do të merren për të formuar mostrën e përbërë nëse lot-i përbëhet nga paketa individuale

Numri i paketave ose njesive në lot	Numri i paketave ose njesive të marra	Pesha minimale e mostrës së përbërë (kg)
1 deri 25	1 paketë ose njësi	1
26 deri 100	Rreth 5%, të paktën 2 paketa ose njësi	1
> 100	Rreth 5%, maksimumi 10 paketa ose njësi	1

Secili lot ose nënlot duhet të kontrollohet për përputhshmërinë dhe të mostrohen të ndara. Megjithatë, në rastin kur një metodë e tillë e marrjes së mostrave çon në pasoja tregtare të papranueshme si rezultat i dëmtimit të lot-it (për arsye të formave të paketimit, mënyrave të transportit, etj.) atëherë aplikohet një mënyrë alternative e marrjes së mostrave, me kusht që mostra e përbërë të jetë sa më përfaqësuese e lot-it të mostruar dhe plotësisht e përshkruar dhe dokumentuar.

### A.3. Marrja e mostrës në fazën e shitjes me pakicë

Marrja e mostrave të produkteve ushqimore në fazën e shitjes me pakicë do të bëhet, kur është e mundur, në përputhje me dispozitat e marrjes së mostrave të paraqitura në pikën A.2 të kësaj Shtojce. Në rastet kur nuk është e mundur, mund të përdoret një metodë alternative e marrjes së mostrës me kusht që ajo të sigurojë se mostra e përbërë të jetë sa më përfaqësuese e lot-it të mostruar dhe plotësisht e përshkruar dhe dokumentuar.

### A.4. Vlerësimi i pranimit të lot-it ose nënlot-it

- Mostra pranohet nëse mostra laboratorike përputhet me kufirin maksimal, duke marrë parasysh pasigurinë në matje dhe korigjimin që i bëhet;
- Mostra refuzohet nëse mostra laboratorike tejkalon kufirin maksimal mbi atë të gjykueshëm duke marrë parasysh pasigurinë në matje dhe korigjimin që i bëhet.

## B. PËRGATITJA E MOSTRËS

1. Në rastin e marrjes së mostrës së produktit të freskët, mostra e përgatitur të transportohet brenda 24 orëve nga marja e mostrës nëse është e mundur. Nëse jo, mostra të mbahet e ngrirë (maksimumi deri në 6 javë).
2. Dheu dhe pjesët e tjera të jashtme që nuk janë të ngrënshme dhe që çojnë në prishje të mostrës të hiqen nga secila njësi. Larja e mostrave nuk lejohet nëse përmbajtja e nitrateve largohet nga larja e tyre.
3. Mostra e plotë homogjenizohet (shtimi i vlerës së njohur të ujit është jo i detyruar). Në varësi të masës së përzierësit/tretësit/goditësit të përdorur, për qëllime homogjenizimi mund të kombinohen një ose më shumë njësi individuale. Përzierja mund të ndihmohet nga ngrirja e thellë duke kryer goditje para se të kryhet homogjenizimi. Ai duhet të demonstrojë që procesi i homogjenizimit të përdorur ka bërë homogjenizim të plotë. Homogjenizimi është themelor për ekstraktimin maksimal dhe nxjerjen e nitratit. Mostrat të trajtohen njëjloj në mënyrë të pavarur nga koha kur ato janë marrë nga fusha ose shitja me pakicë.

## C. METODA E ANALIZËS, RAPORTIMI I REZULTATEVE DHE KËRKESAVE LABORATORIKE TË KONTROLLIT

### C.1. Përkufizime

Me termat e mëposhtëm do të kuptohet:

$r$  = Përsëritshmëria, vlera e poshtëme e të cilës është diferenca absolute midis dy rezultateve të një testi të vetëm të marë në kushte përsëritshmërie, që do të thotë mostër e njëjtë, operator i njëjtë, aparaturë e njëjtë, laborator i njëjtë, dhe intervali i kohës të jetë brenda një propabiliteti specifik (rreth 95%) dhe prandaj  $r = 2,8 \times Sr$ .

$Sr$  = devijimi standard, llogaritur nga rezultatet e mara në kushte përsëritshmërie.

$RSDr$  = devijimi standard relativ, llogaritur nga rezultatet e mara në kushte përsëritshmërie ( $Sr/\bar{x}$ ) x 100).

$R$  = riprodhueshmëria, vlera e poshtëme e të cilës është diferenca absolute midis rezultateve të një testi të vetëm të marrë në kushte riprodhueshmërie, që do të thotë një material identik i marë nga operatorët në laboratorë të ndryshëm duke përdorur metodën e testit të standartizuar që mendohet të shtrihet brenda një propabiliteti specifik (rreth 95%);  $R = 2,8 \times SR$ .

$SR$  = devijimi standard, llogaritur nga rezultatet në kushte riprodhueshmërie.

$RSDR$  = devijimi standard relativ llogaritur nga rezultatet e mara në kushte riprodhueshmërie ( $SR/\bar{x}$ ) x 100.

## C.2. Kërkesa të përgjithshme

Metodat e analizës të përdorura për qëllimet e kontrollit zyrtar përputhen me dispozitat e pikës 1 dhe 2 të Aneksit III të Urdhërit nr. 382 datë 31.07.2006 "Për miratimin e rregullores "Mbi organizimin e kontrolleve zyrtare të bëra për të verifikuar përputhjen me legjislacionin për ushqimin e njerëzve e të kafshëve dhe rregullat për shëndetin si dhe mirëqenien e kafshëve".

## C.3. Kërkesa specifike

### C.3.1. Procedura e ekstraktimit

Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet procedurës së aplikuar për ekstraktim. Disa procedura ekstraktimi janë provuar për të garantuar një ekstraktim të efektshëm të nitratesve, të tilla si uji i ngrohtë ose metanol/ujë (30/70). Ekstraktimi me ujë të ftohtë mund të përdoret vetëm nëse mostra analitike ngrihet përpara ekstraktimit.

### C.3.2. Kriteri i performancës

Kriteri specifik për metodat e analizës së përdorur në monitorimin e niveleve të nitratesve është:

Kriteri	Kufiri i përqëndrimit	Vlera e rekomanduar	Vlera maksimale e lejuar
Nxjerja	< 500 mg/kg	60-120 %	
	≥ 500 mg/kg	90-110 %	
Saktësia RSD <sub>R</sub>	E gjitha	Si është nxjerë nga ekuacioni Horwitz	2 x vlerën e nxjerë nga ekuacioni Horwitz
Saktësia e RSD <sub>R</sub> mund të llogaritet si 0,66 herë saktësia e RSD <sub>R</sub> në përqëndrimin e duhur			

*Shënime për kriterin e performancës*

- Kufijtë e përqëndrimit nuk shpallen, aq sa vlerat e saktësisë të jenë llogaritur në përqëndrimet e duhura,
- Vlerat e saktësisë llogariten nga ekuacioni Horwitz:

$$RSDR = 2^{(1-0.5\log C)}$$

ku:

- RSD<sub>R</sub> është devijimi standard relativ i llogaritur nga rezultatet e mara në kushtet e riprodhueshmërisë ( $S_R/\bar{X}$ ) x 100
- C është raporti i përqëndrimit (p.sh. 1 = 100g/100g), 0.001 = 1 000 mg/kg).

## RELACION SHPJEGUES PËR PROJEKT UDHËZIMIN

### “PËR METODAT E MARRJES SË MOSTRAVE DHE ANALIZIMIT PËR KONTROLLIN ZYRTAR TË NIVELIT TË NITRATEVE NË PRODUKTET USHQIMORE”

Ky projekt Udhëzim ka për qëllim të plotësojë një kërkesë bashkëkohore për rritjen e cilësisë dhe sigurisë së produkteve ushqimore nëpërmjet përsosjes së ligjshmërisë në fushën e ushqimit në zbatim të ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 "Për Ushqimin".

Ky projekt Udhëzim është planifikuar në programin e punës së Ministrisë dhe në "Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA".

Projekt Udhëzimi përcakton mënyrën e marrjes së mostrave, përgatitjen e tyre dhe analizimin për qëllim të kontrollit zyrtar të nivelit të nitrave në produktet ushqimore sipas përcaktimeve të dhëna në Shtojcën bashkëlidhur këtij Udhëzimi. Në lidhje me marrjen e mostrës, ky projekt Udhëzim përcakton personelin që do marrë mostrën, materialin që do mostrohet, masat paraprake që duhet të ndërmerren si dhe të gjithë tipet e mostrave. Ai përcakton mënyrën e marrjes së mostrës, direkt nga fusha apo në lot si dhe parashikon rastet e veprimtimit kur lot-i është i madh e në shitjen me pakicë. Në një Kre të veçantë janë përcaktuar metodat e përgatitjes së mostrës, ku vëmendie tërhiqet në zgjedhjen e mënyrës së ekstraktimit të mostrës. Gjithashtu, ky projekt Udhëzim jep dhe procedurën për raportimin e rezultateve, vlerësimin e matjeve të pasigurisë dhe llogaritjen e përpunimit. Bashkëlidhur projekt Udhëzimit është Shtojca "Metoda e marrjes së mostrës, përgatitja e mostrës dhe analizat për kontrollin zyrtar të niveleve të nitrave në disa produkte ushqimore".

Ky projekt Udhëzim është përgatitur nga përafrimi i pjesshëm i rregullores 1882/2006/EC të 19 Dhjetor 2006 "Mbi metodat e marrjes së mostrave dhe analizimit për kontrollin zyrtar të nivelit të nitrave në produktet ushqimore".

Projekt Udhëzimi nuk ka efekt financiar.

Ky Udhëzim ngarkon për zbatim Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore e Veterinarisë.

DREJTOR

Gani MOKA

